



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Në bazë të nenit 19, paragrafit (2), pikës 12, neneve 40 dhe 94 të Ligjit për arsimin e lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 82/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 178/2021), nenit 12, paragrafit (1), pikës 3, nenit 45, paragrafit (2), pikës 12 dhe nenit 85 të Statutit të Universitetit të Tetovës, Senati i Universitetit të Tetovës, në mbledhjen e mbajtur më 24.11.2022, miratoi:

RREGULLORE
për sigurimin dhe avancimin e cilësisë
në Universitetin e Tetovës

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Kjo Rregullore përcakton standardet dhe procedurën për sigurimin e cilësisë së punës, përbërjen, kompetencat, autorizimet dhe mënyrën e veprimit të subjekteve përgjegjëse për menaxhimin, monitorimin, vlerësimin, përmirësimin dhe zhvillimin e cilësisë në Universitetin e Tetovës (në tekstin e mëtejme: Universiteti).

Neni 2

Qëllimi i vendosjes së sistemit institucional për menaxhimin e cilësisë është përcaktimi dhe zhvillimi i standardeve të cilësisë së punës, rregullimi i mekanizmave dhe procedurave për menaxhimin, monitorimin, vlerësimin, përmirësimin dhe zhvillimin e cilësisë, si dhe zhvillimi i politikës dhe kulturës organizative të cilësisë gjatë realizimit të të gjitha veprimtarive të Universitetit.

II. ORGANET DHE NJËSITË PËR SIGURIMIN E CILËSISË NË UNIVERSITET

Neni 3

- (1) Sigurimi i cilësisë në Universitet është në kompetencë të drejtpërdrejtë të:
- Departamentit për Menaxhimin e Cilësisë dhe Vlerësim,
 - Komisionit Qendror për Vetëvlerësim dhe



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

- komisioneve për vetëvlerësim të njësive të Universitetit.
- (2) Organet dhe njësia nga paragrafi (1) i këtij neni bashkëpunojnë ndërmjet tyre dhe janë në koordinim të vazhdueshëm me organet, trupat dhe njësitë e Universitetit, me qëllim të vetëm - sigurimin e cilësisë.

Neni 4

Në përputhje me Rregulloren për organizimin e brendshëm të Universitetit të Tetovës, Departamenti për Menaxhimin e Cilësisë dhe Vlerësim është kompetent për veprimtaritë e mëposhtme:

- merr pjesë në organizimin dhe koordinimin e punëve administrative në fushën e menaxhimit të cilësisë dhe të vetëvlerësimit të Universitetit dhe të njësive në përbërje të tij;
- merr pjesë në ofrimin e mbështetjes administrative-profesionale për Komisionin për Vetëvlerësim të Universitetit dhe për komisionet për vetëvlerësim të njësive në përbërje të Universitetit;
- merr pjesë në përgatitjen e udhëzimit për vetëvlerësimin, sigurimin dhe vlerësimin e cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë të Universitetit;
- merr pjesë në publikimin e rezultateve të vetëvlerësimit në faqen e internetit të Universitetit;
- ia dorëzon rezultatet e vetëvlerësimit ministrisë kompetente për çështjet e arsimit të lartë;
- merr pjesë dhe ofron mbështetje administrative në realizimin e anketës së studentëve në procesin e vetëvlerësimit, sipas mënyrës së përcaktuar me aktet e Universitetit;
- merr pjesë dhe ofron mbështetje administrative-profesionale në procedurën e rangimit të Universitetit dhe të fakulteteve në përbërje të tij;
- merr pjesë në përcaktimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e proceseve të sistemit të menaxhimit të cilësisë;
- merr pjesë në përgatitjen e materialeve për procedurën e vetëvlerësimit, analizave, raporteve e të ngjashme.

Neni 5

- (1) Anëtarët e Komisionit për Vlerësim të Universitetit zgjidhen nga Senati i Universitetit me votim të fshehtë, nga radhët e mësimdhënësve, me mandat katërvjeçar dhe nga përfaqësuesit e studentëve, me mandat njëvjeçar.
- (2) Gjatë zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit sigurohet përfaqësimi i duhur i të gjitha fushave mësimore-shkencore të Universitetit.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Neni 6

Komisioni Qendror për Vetëvlerësim i kryen këto detyra:

1. organizon dhe koordinon procedurën e vetëvlerësimit në nivel të Universitetit;
2. përcakton metodologjinë, dinamikën dhe mënyrën e realizimit të vetëvlerësimit, në përputhje me standardet, kriteret dhe treguesit e përcaktuar të cilësisë;
3. koordinon realizimin e vetëvlerësimit në fakultetet dhe njësitë e tjera në përbërje të Universitetit;
4. monitoron dhe harmonizon veprimtaritë e komisioneve për vetëvlerësim të fakulteteve;
5. siguron qasje të unifikuar dhe të harmonizuar në zbatimin e standardeve, kriterëve dhe treguesve të vetëvlerësimit;
6. përcakton dhe koordinon të dhënat, dokumentet dhe dëshmitë e tjera të nevojshme për realizimin e vetëvlerësimit në nivel të Universitetit;
7. mbledh, sistematizon dhe analizon të dhënat dhe rezultatet e vetëvlerësimit të dorëzuara nga fakultetet dhe njësitë e tjera;
8. vlerëson përmbushjen e standardeve dhe kriterëve të cilësisë në nivel të Universitetit, në bazë të të dhënave dhe dëshmive të mbledhura;
9. identifikon anët e forta, mangësitë dhe fushat për përmirësimin e cilësisë në nivel të Universitetit;
10. harton projekt-raportin e vetëvlerësimit të Universitetit;
11. propozon masa dhe veprimtari për eliminimin e mangësive të konstatuara dhe për avancimin e cilësisë;
12. monitoron zbatimin e masave dhe veprimtarive të përcaktuara në bazë të rezultateve të vetëvlerësimit;
13. bashkëpunon me organet dhe trupat kompetentë për sigurimin dhe avancimin e cilësisë, si dhe me njësitë në përbërje të Universitetit;
14. sipas nevojës, inicion mbledhjen e të dhënave, analizave dhe dëshmive shtesë nga njësitë në përbërje të Universitetit;
15. kryen edhe detyra të tjera që lidhen me vetëvlerësimin, në përputhje me këtë Rregullore dhe aktet e tjera të Universitetit.

Neni 7

(1) Komisioni për Vetëvlerësim i fakultetit i kryen këto detyra:

1. organizon dhe realizon procedurën e vetëvlerësimit në nivel të fakultetit;
2. zbaton qasjen e përcaktuar metodologjike, standardet, kriteret dhe treguesit e vetëvlerësimit;
3. koordinon veprimtaritë që lidhen me vetëvlerësimin në kuadër të fakultetit;



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

4. përcakton dhe mbledh të dhënat, dokumentet dhe dëshmitë e tjera të nevojshme për vlerësimin e përmbushjes së standardeve dhe kritereve;
 5. verifikon rëndësinë, plotësinë dhe besueshmërinë e të dhënave dhe dëshmimeve të mbledhura;
 6. analizon dhe vlerëson përmbushjen e standardeve, kritereve dhe treguesve në nivel të fakultetit;
 7. përcakton anët e forta, mangësitë, rreziqet dhe fushat për përmirësimin e cilësisë në fakultet;
 8. mbledh dhe analizon mendimet dhe qëndrimet e studentëve, kuadrit mësimor, shërbimeve profesionale dhe palëve të tjera relevante të interesuara;
 9. harton raportin e vetëvlerësimit të fakultetit;
 10. propozon masa dhe veprimtari për eliminimin e mangësive të konstatuara dhe për avancimin e cilësisë në fakultet;
 11. monitoron zbatimin dhe efektet e masave dhe veprimtarive të ndërmarra;
 12. ia dorëzon Komisionit Qendror për Vetëvlerësim, brenda afatit të përcaktuar, raportin e vetëvlerësimit së bashku me të dhënat dhe dëshmitë relevante;
 13. vepron sipas kërkesave dhe udhëzimeve të Komisionit Qendror për Vetëvlerësim lidhur me realizimin e vetëvlerësimit;
 14. bashkëpunon me Komisionin Qendror për Vetëvlerësim dhe me organet e njësitë e tjera të Universitetit për çështjet që lidhen me cilësinë;
 15. kryen edhe detyra të tjera që lidhen me vetëvlerësimin, në përputhje me këtë rregullore dhe aktet e tjera të Universitetit.
- (2) Komisioni për Vetëvlerësim i fakultetit është përgjegjës për saktësinë, plotësinë dhe dorëzimin në kohë të të dhënave dhe dëshmimeve që paraqet në procedurën e vetëvlerësimit.

III. STANDARDET DHE PROCEDURA PËR SIGURIMIN E CILËSISË

Neni 8

- (1) Gjatë zbatimit të procedurës për sigurimin e cilësisë, Universiteti udhëhiqet nga standardet e përcaktuara me Rregulloren për standardet dhe procedurën e vlerësimit të jashtëm dhe të vetëvlerësimit të Këshillit Kombëtar për Arsimin e Lartë, përkatësisht:
 - 1) standardi 1 - politika institucionale për sigurimin e cilësisë;
 - 2) standardi 2 - hartimi, miratimi dhe monitorimi i programeve studimore;
 - 3) standardi 3 - të nxënit, mësimdhënia dhe vlerësimi i orientuar drejt programeve studimore;
 - 4) standardi 4 - regjistrimi dhe përparimi i studentëve, diplomat dhe certifikatat;
 - 5) standardi 5 - kuadri mësimor;
 - 6) standardi 6 - burimet për mësim dhe mbështetja e studentëve;
 - 7) standardi 7 - menaxhimi i informacionit;
 - 8) standardi 8 - informimi i publikut;



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

9) standardi 9 - bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndërkombëtarizimi.

(2) Standardet e përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni realizohen, ndërsa përmbushja e tyre përcaktohet në përputhje me Rregulloren për standardet dhe procedurën e vlerësimit të jashtëm dhe të vetëvlerësimit të Këshillit Kombëtar për Arsimin e Lartë.

Neni 9

- (1) Procedura për sigurimin e cilësisë zbatohet në përputhje me standardet e përcaktuara në nenin 3 të kësaj Rregulloreje.
- (2) Procedura themelore për sigurimin dhe avancimin e cilësisë zbatohet në bazë të standardeve, kriterëve dhe treguesve të përcaktuar të cilësisë dhe përfshin monitorimin, vlerësimin dhe avancimin sistematik të cilësisë në fushat që mbulohen nga standardet.
- (3) Procedura themelore nga paragrafi (2) i këtij neni përfshin në veçanti:
 - përcaktimin dhe monitorimin e përmbushjes së standardeve, kriterëve dhe treguesve të cilësisë;
 - mbledhjen, verifikimin dhe analizimin e të dhënave dhe dëshmive relevante për vlerësimin e cilësisë;
 - përcaktimin e shkallës së përmbushjes së standardeve dhe kriterëve;
 - identifikimin e anëve të forta, mangësive dhe nevojave për përmirësim;
 - përcaktimin dhe zbatimin e masave dhe veprimtarive për sigurimin dhe avancimin e cilësisë;
 - monitorimin e zbatimit të masave dhe veprimtarive, si dhe vlerësimin e efektivitetit të tyre;
 - dokumentimin dhe raportimin e rezultateve të procedurës; dhe
 - ndërmarrjen e veprimeve përkatëse në bazë të rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit.
- (4) Procedura nga paragrafi (3) i këtij neni zbatohet si cikël i vazhdueshëm i planifikimit, realizimit, monitorimit, vlerësimit dhe avancimit të cilësisë.

Neni 10

- (1) Në Universitet dhe në njësitë e Universitetit zbatohet sistem i vetëvlerësimit të cilësisë së kuadrit akademik dhe të programeve studimore të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të studimeve universitare.
- (2) Vetëvlerësimi realizohet në intervale jo më të gjata se tre vjet.
- (3) Pjesë përbërëse e vetëvlerësimit është anketa e studentëve për cilësinë e kuadrit mësimor dhe bashkëpunëtorëve, e cila realizohet në gjysmën e dytë të semestrit, përkatësisht të vitit akademik, veçmas për secilën lëndë, varësisht nëse bëhet fjalë për lëndë njësemestrale ose dysemestrale.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

IV. RAPORTI I VETËVLERËSIMIT

Neni 11

- (1) Raporti i vetëvlerësimit përmban paraqitje të sistematizuar dhe analizë të gjendjes në fushat e përfshira me standardet dhe kriteret e cilësisë.
- (2) Raporti i vetëvlerësimit përmban në veçanti:
 1. të dhëna të përgjithshme për institucionin, përkatësisht për njësinë në përbërje të Universitetit;
 2. metodologjinë dhe rrjedhën e vetëvlerësimit të realizuar;
 3. paraqitjen e gjendjes dhe vlerësimin e përmbushjes së secilit standard dhe kriter;
 4. të dhëna, tregues dhe dëshmi relevante, mbi bazën e të cilave është kryer vlerësimi;
 5. analizën e gjendjeve, rezultateve dhe prirejeve të konstatuara;
 6. rekomandime dhe propozim-masa për sigurimin dhe avancimin e cilësisë;
 7. prioritetet për përmirësim dhe propozimin e afateve për realizimin e tyre;
 8. përfundimin me vlerësim të përgjithshëm të gjendjes dhe të shkallës së përmbushjes së standardeve;
 9. shtojca me të dhëna, dokumente, tabela dhe dëshmi të tjera relevante.
- (5) Vlerësimi i përmbushjes së standardeve dhe kriterëve mbështetet në të dhëna dhe dëshmi objektive, të verifikueshme dhe relevante.

Neni 12

- (1) Raporti i vetëvlerësimit hartohet në mënyrë që të mundësojë monitorimin e ndryshimeve në cilësi dhe krahasimin e rezultateve me ciklet e mëparshme të vetëvlerësimit.
- (2) Raporti i vetëvlerësimit plotësohet sipas formularit të përcaktuar nga Bordi për Vlerësim.
- (3) Raporti dorëzohet edhe në gjuhën angleze.
- (4) Raporti i vetëvlerësimit publikohet detyrimisht në faqen zyrtare të Universitetit në internet.
- (5) Gjatë realizimit të procedurës së vetëvlerësimit zbatohen edhe formularët e tjerë të nevojshëm, të përcaktuar me Rregulloren për standardet dhe procedurën e vlerësimit të jashtëm dhe të vetëvlerësimit të Këshillit Kombëtar për Arsimin e Lartë.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 13

- (1) Për çdo çështje që nuk është rregulluar me këtë Rregullore zbatohen dispozitat e Ligjit për arsimin e lartë, Rregullores për standardet dhe procedurën e vlerësimit të jashtëm dhe të vetëvlerësimit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 153/2022), Statutit të Universitetit të Tetovës, statuteve të njësive të Universitetit, Udhëzimit për sigurimin e cilësisë, si dhe akteve të tjera të brendshme të Universitetit me të cilat rregullohet kjo veprimtari.
- (2) Udhëzimi për sigurimin e cilësisë është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 14

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj nga Senati i Universitetit.

Kryetar i Senatit,

Prof. Dr. Vullnet Ameti

